



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.250/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbareme të kreditorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër debitorit D.P.T. “Emiri” me seli në Mitrovicë, me bazë juridike përmbareme, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë CP.nr.334/2013 të datës 04.10.2023, me datë 12.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, CP.nr.334/2013 i datës 04.10.2023 dhe lënda i kthehet në rigjykim dhe rivendosje Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së Parë.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktvendimin e ankimuar CP.nr.334/2013 të datës 04.10.2023, ka përfunduar procedurën përmbareme të kreditorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, kundër debitorit D.P.T. “Emiri” me seli në Mitrovicë, që zhvillohet në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, në bazë të aktvendimit CP.nr.334/2013 të datës 19.03.2018.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës përmbareme dhe kontestimore, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa, ndërsa aktvendimi i ankimuar të priset dhe lënda t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në riprocedurë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbareme (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, me datë 20.05.2013, ka paraqitur propozim për përmbareme kundër debitorit D.P.T. “Emiri” me seli në

Mitrovicë, në bazë të dokumentit të dokumentit përmbarues – aktvendimit nr.04.2.3.1/815 të datës 05.01.2011

Gjykata Themelore në Mitrovicë, duke vepruar në bazë të propozimit për përmbarim të kreditorit me aktvendimin CP.nr.334/2013 të datës 19.03.2018, ka lejuar përmbarimin.

Gjykata e shkallës së parë me datë 12.10.2021 ka nxjerr konkluzionin me të cilin ka urdhëruar kreditorin që në afat prej 3 ditëve, pas pranimit të konkluzionit, gjykatës t'i sjellë adresën e saktë të debitorit, pasi që sipas shkresave të lëndës konstatohet se firma është mbyllur dhe pronari është në perëndim. Kreditori me parashtrësë ka njoftuar gjykatën e shkallës së parë për adresën e re të debitorit D.P.T. "Emiri" me seli në Mitrovicë, rr."Ahmet Maloku", me pronar M.K.. Gjykata Themelore në Mitrovicë me datë 03.02.2022, ka nxjerr konkluzion tjetër, me të cilin ka urdhëruar kreditorin që në afat prej 3 ditëve, pas pranimit të konkluzionit, gjykatës t'i sjellë adresën e saktë të debitorit mbi të cilën është ngritur vendimi për përmbarim, për shkak se në adresën ekzistuese i njëjti gjendet jashtë vendit siç vërtetohet me flete kthesën e datës 29.10.2021. Kreditori me parashtrësën e datës 14.02.2022, ka njoftuar gjykatën e shkallës së parë se duke ju referuar të dhënave të siguruar nga Sektori i Inteligjencës rezultojnë dy adresa për debitorin, 1. D.P.T. "Emiri" me seli në Mitrovicë, rr."Sali Ceku", me pronar M.K. dhe 2. D.P.T. "Emiri" me seli në Mitrovicë, rr."Ahmet Maloku 54", me pronar M.K.. Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin Cp.nr.334/2013 të datës 19.07.2022 ka pezulluar procedurën përmbarimore të kreditorit për shkak të realizimit të pamundur, në kuptim të dispozitës se nenit 65 të LPP-së.

Gjykata Themelore në Mitrovicë me aktvendimin CP.nr.334/2013 të datës 04.10.2023, ka përfunduar procedurën përmbarimore të kreditorit Dogana e Kosovës, me arsyetimin se kreditori brenda afatit prej 6 muajve nuk ka paraqitur informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, andaj konform dispozitës se nenit 65 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së ka përfunduar procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë nuk mund ta pranojnë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 dhe 66 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, të cilat shkelje aktvendimin e ankimuar e bëjnë jo të drejtë dhe jo të ligjshëm.

Me dispozitën e nenit 66 paragrafi 1 të LPP-së, shprehimisht është paraparë se: *"Në qoftë se me këtë ligj nuk është paraparë ndryshe përmbarimi do të përfundoj sipas detyrës zyrtare në qoftë se dokumenti përmbarimor është anuluar, ndryshuar, shfuqizuar apo në ndonjë mënyrë tjetër është bërë i pa efekt apo në qoftë së vërtetimi për përmbarueshmërinë e tij anulohet me vendim të formës së prerë. Përmbarimi do të mbaroj gjithashtu sipas detyrës zyrtare nëse një rast është pezulluar 2*

dy herë dhe përherë i plotëson kriteret për pezullim siç përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 65 të këtij ligji.

Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton se përfundimi i procedurës do të bëhet kur *dokumenti përmbartimor është anuluar, ndryshuar, shfuqizuar apo në ndonjë mënyrë tjetër është bërë i pa efekt apo në qoftë së vërtetimi për përmbartueshmërinë e tij anulohet me vendim të formës së prerë apo nëse një rast është pezulluar dy herë dhe i plotëson kriteret për pezullim siç përcaktohet në paragrafin 1 të nenit 65 të këtij ligji*, çka në rastin konkret nuk kanë qenë të plotësuara asnjëra nga kushtet e parapara me këtë dispozitë, kjo ngase me shikim në shkresat e lëndës kjo gjykatë konstaton se kreditori me parashtrësën e datës 28.10.2022 brenda afatit ligjor të caktuar me aktvendimin Cp.nr/334/2013 të datës 19.07.2022, i ka siguruar gjykatës informatat të reja lidhur me adresën e debitorit, D.P.T. “Emiri” me seli në Mitrovicë, rr.“Avni Shabani”, me pronar M.K., nga ku rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk ka vepruar konform adresës së re të paraqitur nga kreditori.

Të gjitha këto shkelje procedurale të konstatuara nga gjykata ankimore, aktvendimin e ankimuar të nxjerr nga gjykata e shkallës së parë e bëjnë jo të drejtë dhe pa mbështetje në ligj.

Gjykata Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, udhëzohet që në ri procedurë të ndërmer veprimet e nevojshme ekzekutive të parapara me dispozitat ligjore të LPP-së, me qëllim që të mund të realizohet kërkesa që kreditori ka ndaj debitorit, e që procedura në këtë çështje përmbartimore pas përmbushjes së detyrimit të mund të përfundohet ashtu siç parashihet me dispozitën e nenit 66 paragrafi 4 të LPP-së.

Nga arsyet e cekura e në pajtim me dispozitën e nenit 194, 208 dhe 209 paragrafi 1, pika (d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.Dh.Sh.II.nr.250/2024 me datë 12.04.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha